



Republika e Kosovës • Republika Kosovo • Republic of Kosovo  
Institucioni i Avokatit të Popullit • Institucija Ombudsmena • Ombudsperson Institution

---

## AVOKATI I POPULLIT

### OPINION

R.nr.50/2024

*Në lidhje me detyrimet e organeve shtetërore për të vepruar në përputhje me parimet e Ligjit për Mbrojtje nga Diskriminimi*

#### Drejtuar:

Z. Habib Basholli, kryesues i Bordit  
Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale

#### Për dijeni të:

Z. Glauk Konjufca, kryeparlamentar  
Kuvendi i Republikës së Kosovës

Prishtinë, më 3 dhjetor 2024

## Qëllimi

1. Ky Opinion ka për qëllim të shprehë qëndrimet e Avokatit të Popullit lidhur me detyrimet e organeve shtetërore që gjatë ushtrimit të detyrave dhe të përgjegjësive të tyre të vepron në përputhje me parimet e Ligjit për Mbrojtje nga Diskriminimi dhe me legjislacionin përkatës në fuqi.

## Kompetencat dhe përgjegjësitë e Avokatit të Popullit

2. Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 132, paragrafi 1, përcakton: *“Avokati i Popullit mbikëqyrë dhe mbron të drejtat dhe liritë e individëve nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme dhe të parregullta të autoriteteve publike.”*
3. Neni 135, paragrafi 3, përcakton: *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa, nëse vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga ana e organeve të administratës publike dhe organeve të tjera shtetërore.”*
4. Ligji nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, ndër të tjerash, përcakton këto kompetenca dhe përgjegjësi për Avokatin e Popullit: *“Avokati i Popullit ka kompetencë të bëjë hetime goftë për t’iu përgjigjur ankesës së parashtruar apo me iniciativën e vet (ex officio), nëse nga konstatimet, dëshmitë dhe faktet e paraqitura me parashtrësë ose nga njohuritë e fituara në mënyrë tjetër, ka bazë të rezultojë se nga ana e autoriteteve janë shkelur të drejtat dhe liritë e njeriut të përcaktuara me Kushtetutë, ligje dhe akte të tjera, si dhe me instrumente ndërkombëtare për të drejtat e njeriut.”* (neni 16.4); si dhe: *“T’i publikojë njoftimet, mendimet, rekomandimet, propozimet dhe raportet e veta.”* (neni 18, paragrafi 1, nënparagrafi 1.6).
5. Ligji nr. 05/L-020 për Barazi Gjinore, neni 13 [Avokati i Popullit], përcakton: *“Avokati i Popullit është institucion i barazisë që trajton rastet që lidhen me diskriminimin gjinor, në përputhje me procedurat e parapara me Ligjin për Avokatin e Popullit.”*
6. Ligji nr. 05/L-021 për Mbrojtje nga Diskriminimi, neni 9 [Avokati i Popullit], paragrafi 1, përcakton: *“Avokati i Popullit është Institucion i shtetit, i cili bënë promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Avokati i Popullit trajton rastet që kanë të bëjnë me diskriminimin sipas ligjit përkatës për Avokatin e Popullit.”*

## Rrethanat e rastit

7. Avokati i Popullit, në bazë të nenit 16, paragrafi 1, të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, më 19 janar 2024 ka pranuar ankesën e znj. Selvete Grajqevcit Pllanës (në tekstin e më tejme: ankuesja), parashtruar kundër Komisionit të Pavarur për Miniera e Minerale (KPMM), me pretendime për diskriminim në bazë të moshës me rastin e marrjes së vendimit për ndërprerje të marrëdhënies së punës si kryesuese e bordit të KPMM-së.
8. Sipas shkresave në lëndë dhe pohimeve të ankueses, kuptohet se më 6 dhjetor 2021 Kuvendi i Republikës së Kosovës e ka zgjedhur Bordin e Komisionit të Pavarur për Miniera e Minerale (KPMM) me një mandat 5-vjeçar, me ç’ rast ankuesja ishte zgjedhur kryesuese e Bordit.
9. Më tej ankuesja ka pohuar se më 29 dhjetor 2022, tre anëtarë të Bordit të KPMM-së kanë mbajtur Mbledhjen XXXV për vitin 2022, ku mes të tjerash kanë marrë vendim për pensionimin e ankueses duke u bazuar në Ligjin nr. 03/L-163 për Miniera dhe Minerale dhe në Ligjin nr. 04/L-158 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 03/L-163 për

Miniera dhe Minerale (më tej: Ligji për MM), në kuptim të nenit 59, pika 3, si dhe në Ligjin 06/L-113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura.

10. Ndërsa më 30 dhjetor 2022, zëvendës drejtori i KPMM-së e ka formatizuar vendimin e Bordit të KPMM-së me Vendimin nr. ref. 024/2022 dhe nr. prot.4472, si dhe duke e obliguar ankuesen t'i dorëzonte te zyrtari përgjegjës të gjitha pajisjet me të cilat ka qenë e ngarkuar për kryerjen e detyrave të punës e që janë pronë e KPMM-së (vendimi është korrigjuar te pjesa e arsyetimit me Vendimin ref. 05/2023 dhe nr. prot. 476/2023, datë 15 shkurt 2023).
11. Ankuesja pretendon se përfundimi i marrëdhënies së saj të punës në KPMM, nga Bordi i KPMM-së, për shkak të arritjes së moshës së pensionimit, e ka diskriminuar atë në aspektin e moshës, por edhe të gjinisë, si dhe i janë shkelur të drejtat e saj nga marrëdhënia e punës si kryesuese e Bordit të KPMM-së, rrjedhimisht i është cenuar e drejta e ushtrimit të funksionit të kryesueses së Bordit, me mandat nga Kuvendi Republikës së Kosovës, si i vetmi institucion që ka mundur ta shkarkonte atë, me ç' rast, sipas ankueses, i është shkaktuar dëm material dhe jomaterial.
12. Ankuesja ka pohuar se më 1 shkurt 2023, kundër vendimit të KPMM-së për pensionimin e saj, ka parashtruar Padi C. nr. 1753/2023 në Gjykatën Themelore në Prishtinë, me kërkesë për shtyrje të ekzekutimit të këtij vendimi. Më 4 janar 2024, Gjykata Themelore në Prishtinë ka marrë Aktvendimin C.nr. 1753/2023, me të cilin e ka refuzuar në tërësi si të pabazuar propozimin e ankueses.
13. Më 11 korrik 2023, Komisioni për Ekonomi, Industri, Ndërmarrësi dhe Tregti i Kuvendit të Republikës së Kosovës, si komision që kishte kërkuar shkarkimin e Bordit, i ka ftuar në takim anëtarët e Bordit të KPMM-së për t'ua dhënë mundësinë për t'u pyetur, dëgjuar, për t'u bërë pyetje kërkuarve të shkarkimit dhe për t'i paraqitur shpjegimet e tyre.
14. Më 26 tetor 2023, Kuvendi i Republikës së Kosovës në seancën plenare ka shkarkuar Bordin e KPMM-së, përfshirë edhe ankuesen.
15. Më 16 gusht 2024, Avokati i Popullit i është drejtuar me shkresë kryesuesit të Bordit të KPMM-së duke e njoftuar atë për pretendimet e ankueses dhe duke i kërkuar informacione lidhur me çështjen, në veçanti janë kërkuar informacione nëse ka pasur raste kur anëtarët e Bordit të KPMM-së kanë vazhduar mandatin e tyre si të emëruar nga ana e Kuvendit deri në fund edhe pas arritjes së moshës së pensionimit.
16. Më 22 gusht 2024, Avokati i Popullit i është drejtuar me shkresë zëvendësuesit të sekretarit të përgjithshëm të Kuvendit të Republikës së Kosovës për një interpretim autentik të Ligjit për MM-në, respektivisht të nenit 59, paragrafi 3: *“A nënkupton largimi i ligjshëm nga pozita i çdo anëtar i të bordit të KPMM-së edhe arritja e moshës 65 vjeç?”* Deri në publikimin e këtij Opinioni, Avokati i Popullit nuk ka marrë përgjigje nga Kuvendi i Republikës së Kosovës.
17. Më 30 gusht 2024, Avokati i Popullit ka marrë përgjigje nga kryesuesi i Bordit të KPMM-së, me të cilën ndër të tjerash është njoftuar se që nga themelimi i KPMM-së ka pasur anëtarë të Bordit të KPMM-së që gjatë ushtrimit të mandatit e kanë arritur moshën e pensionimit dhe e kanë vazhduar mandatin deri në fund, dhe për këtë ka ofruar edhe dokumente.

## Vlerësimi i Avokatit të Popullit

18. Me Ligjin për MM-në, përkatësisht nenin 59, është përcaktuar procedura deri te zgjedhja e Bordit të KPMM-së nga Kuvendi i Republikës së Kosovës si dhe është përcaktuar mandati i të gjithë pasardhësve të anëtarëve fillestarë (pesë vjet). Po ashtu, me nenin 60 të po të njëjtit ligj janë përcaktuar kriteret dhe procedura për shkarkimin e anëtarëve të Bordit të KPMM-së nga Kuvendi i Republikës së Kosovës.
19. Avokati i Popullit vëren se Kuvendi i Republikës së Kosovës, më 6 dhjetor 2021, duke u mbështetur në nenin 59 të Ligjit për MM-në, ka zgjedhur anëtarët e Bordit të KPMM-së me mandat 5-vjeçar, me ç' rast ankuesja ishte zgjedhur kryesuese e bordit.
20. Avokati i Popullit vëren se më 29 dhjetor 2022, tre anëtarë të Bordit kishin marrë vendim për pensionimin e ankueses duke u bazuar në Ligjin për MM-në dhe në kuptim të nenit 59, pika 3, si dhe në Ligjin 06/L-113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura.
21. Lidhur me këtë, Avokati i Popullit vlerëson se ankuesja nuk kishte arritur ta përfundonte mandatin si kryesuese e Bordit prej pesë vjetësh, ashtu siç ishte zgjedhur nga Kuvendi i Republikës së Kosovës. Për më tepër, për shkak të arritjes së moshës, tre anëtarët e tjerë të Bordit e kishin pensionuar ankuesen, vendimi i të cilëve ishte mbështetur në nenin 59, pika 3, të Ligjit për MM-në. Avokati i Popullit vlerëson se Bordi i KPMM-së i ka tejkaluar kompetencat e veta sipas ligjit në fjalë, meqë kjo kompetencë është ekskluzive e Kuvendit të Republikës së Kosovës.<sup>1</sup>
22. Më tutje Avokati i Popullit vëren se Kuvendi i Republikës së Kosovës nuk kishte reaguar për një veprim të tillë të të tre anëtarëve të Bordit. Përkundrazi, Komisioni për Ekonomi, Industri, Ndërmarrësi dhe Tregti i Kuvendit të Republikës së Kosovës, pas disa muajsh (11 korrik 2023), i kishte ftuar në një takim anëtarët e Bordit të KPMM-së për çështje që ndërlidheshin me punën dhe përgjegjësinë e tyre si Bord, ku e pranishme në takim ishte edhe ankuesja, edhe pse më vonë Kuvendi i Republikës së Kosovës kishte shkarkuar gjithë Bordin, përfshirë edhe ankuesen (26 tetor 2023).
23. Për më tepër, Avokati i Popullit vlerëson se marrja e një vendimi të tillë për pensionim të ankueses, nga një organ jokompetent, është në kundërshtim edhe me Ligjin nr. 05/l -031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, konkretisht me nenin 4, paragrafi 1, të tij, i cili ka përcaktuar parimin e ligjshmërisë.<sup>2</sup>
24. Avokati i Popullit konsideron se një vendim i tillë është i paligjshëm në kuptim të nenit 52 të po këtij ligji, i cili përcakton paligjshmërinë e aktit administrativ nëse *“është nxjerrë në mungesë të autorizimit nga një ligj, sipas paragrafit 2 të nenit 4 të këtij Ligji ( paragrafi 1, nën paragrafi 1.1); dhe organi publik që e nxjerr ka vepruar pa pasur kompetencë.”* (nënparagfi 1.2).
25. Avokati i Popullit nga përgjigjja dhe dokumentet që ka pranuar nga KPMM-ja, vëren se nuk është ndjekur një praktikë e tillë në të kaluarën nga KPMM-ja me njërin nga anëtarët e Bordit (mashkull), në një rast të njëjtë sikurse i ankueses, ku njëri nga anëtarët e Bordit

<sup>1</sup> Ligji nr. 03/L-163 për Miniera dhe Minerale dhe Ligjin nr. 04/L-158 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 03/L-163 për Miniera dhe Minerale, përkatësisht neni 60 [Shkarkimi i anëtarëve të bordit].

<sup>2</sup> Ligjin nr. 05/L -031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, neni 4, paragrafi 1: *“Organet publike veprojnë në përputhje me Kushtetutën, legjislacionin në fuqi, si edhe me rregullat e përgjithshme administrative të zbatueshme brenda kompetencave të tyre dhe në përputhje me qëllimin për të cilat janë dhënë këto kompetenca.”*

gjatë ushtrimit të mandatit e kishte arritur moshën e pensionimit (2010-2014), por e kishte vazhduar mandatin deri në përfundim.

26. Për ankuesen, vendimi i anëtarëve të Bordit ka prodhuar pasoja, është larguar nga lista e pagave dhe nuk ka pasur mundësi ta ushtronte mandatin për aq sa ka zgjatur (26 tetor 2023 janë shkarkuar të gjithë anëtarët e bordit nga Kuvendi i Republikës së Kosovës), për të cilën ishte zgjedhur nga Kuvendi i Republikës së Kosovës.
27. Sipas vlerësimit të Avokatit të Popullit, vendimi i anëtarëve të Bordit të KPMM-së ka krijuar një gjendje juridike të paprecedent deri më tani nga ky institucion dhe nuk është zbatuar praktika e njëjtë për të gjitha rastet.

### **Përfundim**

28. Avokati i Popullit, pa i paragjykuar proceset e tjera që ndërlidhen me çështjen e ankueses, vlerëson se KPMM-ja nuk ka autorizim ligjor për përfundimin e mandatit të asnjë anëtari të bordit dhe se vendimi për pensionimin e ankueses si anëtare e bordit, sipas përcaktimeve ligjore është i paligjshëm. Sipas përcaktimit ligjor, përfundimi i mandatit të anëtarëve të bordit është kompetencë ekskluzive e Kuvendit të Republikës së Kosovës.<sup>3</sup>
29. Për më tepër, Avokati i Popullit vlerëson se KPMM-ja jo vetëm që ka tejkaluar kompetencat ligjore që ka, por ka vepruar edhe në kundërshtim me Ligjin për Mbrojtje nga Diskriminimi.
30. Avokati i Popullit konstaton se ankuesja, me nxjerrjen e vendimit për pensionimin e saj si anëtare e Bordit, është diskriminuar nga Bordi i KPMM-së mbi bazën e moshës dhe të gjinisë, e që si pasojë nuk ka arritur që ta përfundonte mandatin. Ankuesja është vënë në pozitë të pabarabartë krahasuar me një anëtar tjetër (mashkull) të Bordit të KPMM-së, i cili e kishte ushtruar mandatin e plotë, brenda periudhës 2010-2014, megjithëse brenda kësaj periudhe e kishte arritur moshën e pensionimit, i cili, edhe pse ishte pensionuar, e kishte vazhduar mandatin deri në përfundim, fakt ky i cili nuk ishte marrë parasysh nga Bordi i KPMM-së me rastin e përfundimit të mandatit të ankueses.
31. Për më tepër, Avokati i Popullit konstaton se rasti i ankueses përbën diskriminim të shumëfishtë sipas përcaktimit të Ligjit për Mbrojtje nga Diskriminimi, neni 4, paragrafi 1, nënparagrafi 1.10, i cili ndodh kur diskriminimi është i bazuar në çfarëdo kombinimi mbi bazat e mbuluara me këtë ligj.
32. Avokati i Popullit vlerëson se përpos zbatimit të të gjitha ligjeve të tjera të cilat janë në fuqi, KPMM-ja e ka për obligim që gjatë ushtrimit të veprimtarisë së vet të veprojë në përputhje të plotë me parimet e Ligjit për Mbrojtje nga Diskriminimi. Moszbatimi i parimeve të Ligjit për Mbrojtje nga Diskriminimi shpie në shkelje të së drejtës së njeriut, respektivisht në diskriminim, sikurse në rastin e ankueses.

Me nderime,

Naim Qelaj  
Avokat i Popullit

<sup>3</sup> Ligji nr. 03/L-163 për Miniera dhe Minerale dhe Ligjin nr. 04/L-158 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 03/L-163 për Miniera dhe Minerale, përkatësisht neni 60 [Shkarkimi i anëtarëve të bordit].